

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria Vega SHPK Valevo me seli të regjistruar në Dr. Bore Blagojeviça nr.30, Valevo, Serbia, i dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Georgievski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 03.04.2025, miratoi

AKTVENDIM

Konstatohet se përqendrimi me të cilin Vega SHPK Valevo me seli në Dr. Bore Blagojeviça nr.30, Valevo, Serbia, do të fitojë kontroll të plotë mbi PZU Apoteka BENU Podgorica me seli në Kritskog Odreda 4/1, Podgoricë, Mal i Zi, Farmegra d.o.o. Podgoricë me seli në Kritskog Odreda 4/1, Podgoricë, Mal i Zi, Feniks d.o.o. Bijeljina me seli në Donja Ljeljença 015B, Ljeljença Bijeljina, Republika Sërpska, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Feniks Farma SHPKNJP Shkup me seli në Jadranska Magistrala nr.31, Shkup - Butel, Maqedonia e Veriut, përmes blerjes direkte të 100% të pjesëve të shoqërive, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengesë, kufizim apo shtrembërim të rëndësishëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, sidomos si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë tarifë administrative për njoftim për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 denarë dhe për vendimin në vlerë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 05.03.2025 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Vega SHPK Valevo me seli të regjistruar në Dr. Bore Blagojeviça nr.30, Valevo, Serbi, me të cilin Vega SHPK Valevo do të fitojë kontroll të plotë mbi PZU Apoteka BENU Podgoricë me seli në Kritskog Odreda 4/1, Podgorica, Mal i Zi, Farmegra d.o.o. Podgoricë me seli në Kritskog Odreda 4/1, Podgoricë, Mal i Zi, Feniks d.o.o. Bijeljina me seli në Donja Ljeljença 015B, Ljeljença Bijeljina, Republika Sërpska, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Feniks Farma SHPKNJP Shkup me seli në Jadranska Magistrala nr.31, Shkup - Butel, Maqedonia e Veriut, përmes blerjes direkte të 100% të pjesëve të shoqërive.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit ditën e pranimi dhe, bazuar në të dhënat e paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe anekset e tij, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjeve të përfshira:

VEGA SHPK VALEVO është një kompani me shumicë farmaceutike që merret me import, furnizim, magazinim, shitje dhe shpërndarje të ilaçeve, pajisjeve mjekësore, produkteve dietetike, kozmetikës dhe produkteve për përdorim të përgjithshëm. Portofoli i VEGA-s përfshin rreth 10.000 artikuj të magazinuar në hapësirë prej 6.500 m², një qendër moderne shpërndarjeje në Valevo, e cila përmbush kërkesat më të larta të praktikës së mirë të shpërndarjes (GDP). VEGA ka 90 mjete transporti me të cilat çdo ditë dërgohen produktet në mbi 3.900 objekte, kryesisht në farmaci private dhe publike, qendra shëndetësore, spitale, qendra klinike në Republikën e Serbisë.

-PZU Apoteka BENU Podgorica është një institucion shëndetësor privat që kryen shitje me pakicë të produkteve farmaceutike në dyqane të specializuara – farmaci. Asortimenti përfshin ilaçe me dhe pa recetë, pajisje mjekësore, suplemente ushqimore, kozmetikë dhe artikuj të përdorimit të përgjithshëm.

-Farmegra doo. Podgorica Farmegra Podgorica ushtron veprimtarinë e tregtisë me shumicë të produkteve farmaceutike. Aktiviteti i Farmegra Podgoricës konsiston në shitjen me shumicë të barnave, pajisjeve mjekësore dhe produkteve para farmaceutike nga prodhues vendas dhe ndërkombëtarë. Farmegra Podgorica furnizon tregun malazez me import të rregullt të barnave të regjistruara, import për kryerjen e studimeve klinike, si dhe import të barnave të paregjistruara sipas kërkesave të veçanta të blerësve me miratimin e institucioneve kompetente. Farmegra Podgorica shpërndan produktet nga qendra e shpërndarjes në Podgoricë.

-Feniks d.o.o. Bijeljina është një kompani farmaceutike me shumicë e themeluar në vitin 1997. Aktiviteti kryesor i kompanisë është furnizimi mjekësor me barna dhe produkte të tjera farmaceutike, i cili është i destinuar për farmaci, spitale dhe objekte të tjera shëndetësore. Kompania operon nga dy qendra moderne rajonale të shpërndarjes, njëra në Bijeljina, ku është selia e kompanisë, dhe tjetra në Sarajevë, e hapur në vitin 2010. Oferta përbëhet nga më shumë se 6000 artikuj dhe dorëzimi dhe shpërndarja bëhet në të gjithë territorin e Bosnjë-Hercegovinës.

-Feniks Shkup ushtron veprimtarinë e tregtisë me shumicë të produkteve farmaceutike, e cila përfshin importin, ruajtjen, shitjen dhe shpërndarjen e produkteve farmaceutike. Puna e kompanisë bazohet në shitjen e barnave, pajisjeve mjekësore dhe suplementeve ushqimore nga prodhues vendas dhe ndërkombëtarë. Shpërndarja e produkteve kryhet nga një qendër shpërndarjeje në Shkup. Klientët më të rëndësishëm janë farmacistë, më pas spitalet shtetërore përmes pjesëmarrjes në tenderë për blerjen e barnave dhe pajisjeve mjekësore, ndërsa një pjesë e shitjes u drejtohet farmacive dhe klinikave të tjera me shumicë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se

përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ